



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të raportimeve vjetore të disa organeve kushtetuese, atyre të ngritura me ligj, si dhe institucionet e varësisë për veprimtarinë e tyre për vitin 2018.

2. Miratimi i kalendarit dhe planit të masave/aktiviteteve për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit European për Shqipërinë, si dhe në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OKB (mars-dhjetor 2019)

3. Shqyrtimi i projektrezolutës "Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë" (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Elena Xhina, Adelina Rista dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Astrit Veliaj, Nasip Naço, Silva Caka

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm, kështu që mund të vazhdojmë me çështjet e rendit të ditës.

Sot kemi tri çështje në rendin e ditës.

1- Miratimi i kalendarit të raportimeve vjetore të disa organeve kushtetuese, atyre të ngritura me ligj, si dhe institucionet e varësisë për veprimtarinë e tyre për vitin 2018.

2- Miratimi i kalendarit dhe planit të masave/aktiviteteve për zbatimin e plan veprimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit European për Shqipërinë, si dhe në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OKB (mars-dhjetor 2019).

3- Shqyrtimi i projektrezolutës "Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë".

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e kalendarit të raportimeve vjetore të disa organeve kushtetuese, atyre të ngritura me ligj, si dhe institucioneve të varësisë për veprimtarinë e tyre për vitin 2018. Është një raportim i përvitshëm. Në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve dhe që raportojnë në komisionin tonë janë rreth 19 institucione. Sivjet janë shtuar edhe organet e reja të sistemit të drejtësisë, si: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Avokatura e Shtetit dhe Komisioni i Pavarur i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Pra, veç atyre që kishim janë shtuar katër organe të reja. Jemi dakord me kalendarin e raportimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke u bashkuar me sugjerimin e kolegut Fino, organet që do të raportojnë në Komisionin e Ligjeve janë:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të raportojë brenda datës 6 mars dhe relator do të jetë kolegu Bashkim Fino;

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të raportojë brenda datës 6 mars dhe relator do të jetë Damian Gjijnuri;

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të raportojë brenda datës 19 mars dhe relatore do të jetë kolegja Elena Xhina;

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të raportojë brenda datës 13 mars dhe relator do të jetë kolegu Alket Hyseni;

Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri do të raportojë deri në datën 20 mars dhe relator do të jetë kolegu Adnor Shameti;

Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të raportojë brenda datës 20 mars dhe relator do të jetë kolegu Adnor Shameti;

Ministri i Drejtësisë do të raportojë brenda datës 9 prill dhe relatore do të jetë kolegia Vasilika Hysi;

Prokurori i Përgjithshëm do të raportojë brenda datës 10 prill dhe relatore do të jetë kolegia Vasilika Hysi;

Avokati i Popullit do të raportojë brenda datës 10 prill dhe relator do të jetë kolegu Spartak Braho;

Inspektori i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe relator do të jetë kolegu Bashkim Fino;

Këshilli i Lartë Gjyqësor do të raportojë brenda datës 14 maj dhe relator do të jetë kolegu Adnor Shameti;

Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të raportojë brenda datës 14 maj dhe relatore do të jetë zonja Bushka;

Agjencia e Trajtimit të Pronave do të raportojë brenda datës 21 maj dhe relator do të jetë zoti Çyrbja;

Avokatura e Shtetit do të raportojë brenda datës 21 maj dhe relator do të jetë zonja Bushka;

Komisioni i Pavarur për Koordinimin e Institucioneve të reja të drejtësisë dhe relator do të jetë kolegia Bushka.

Ky është kalendari i raportimit të institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj, datat përkatëse, si dhe kolegët që do të jenë relatorët e këtyre raportimeve. Jemi dakord?

Bashkim Fino – Unë sugjeroj që për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri të mos jetë relator kolegu Adnor Shameti, por Tom Doshi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose të dy bashkë.

Jam dakord me sugjerimin e zotit Fino që të jenë dy bashkërelatorë, zoti Shameti dhe zoti Doshi. Jeni dakord me kalendarin e raportimeve vjetore?

Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Miratimi i kalendarit dhe planit të masave/aktiviteteve për zbatimin e plan veprimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit European për Shqipërinë si dhe në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OKB (mars-dhjetor 2019)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Elena Xhina, Adelina Rista dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Astrit Veliaj, Nasip Naço, Silva Caka

Ulsi Manja - Vazhdojmë me miratimin e kalendarit dhe planit të masave/aktiviteteve për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë, si dhe në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OKB (mars-dhjetor 2019).

Është një kalendar i detajuar me kohën se kur do të bëhen këto raportime. Ka ndonjë vërejtje apo sugjerim?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në këtë kalendar ka një sërë aktiviteteve që zhvillohen midis Komisionit të Ligjeve dhe nënkomisioneve. Ndërkohë, nënkomisionet kanë mundësinë të kenë edhe aktivitete të tjera, të cilat nuk janë në bashkëpunim me Komisionin e Ligjeve, por mund të jenë me nënkomisionet të tjera parlamentare apo edhe me aktorë të shoqërisë civile.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Ka sugjerime të tjera?

Kolegëve u ka shkuar me *e-mail*, por, gjithsesi, edhe të printuara nuk ka problem.

Jemi dakord me miratimin e kalendarit?

Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet kalendar i planit të masave/aktiviteteve për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë, si dhe në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në kuadrin e OKB-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës "Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë" (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Elena Xhina, Adelina Rista dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Astrit Veliaj, Nasip Naço, Silva Caka

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, shqyrtimi i projektrezolutës "Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë". Ne jemi komision përgjegjës. I lutem zonjës Hysi të bëjë një prezantim të kësaj projektrezolute. Më pas vazhdojmë me pyetje dhe diskutime nga kolegët.

Fjala është për zonjën Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e kemi prezantuar projektrezolutën, por do të doja të theksoja edhe një herë që kjo projektrezolutë synon të njohë dhe të mbështesë veprimtarinë e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, shtetin e së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë.

Përpara keni një projekt të draftit të rezolutës, si dhe relacionin përkatës.

Sot veprimtaria e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sidomos e atyre që mbrojnë grupe të marginalizuara në shoqëri ose grupe që mbrojnë qytetarët nga veprimet abuzive të administratës publike, është rritur dhe është konsoliduar. Këta nuk janë vetëm individë, por janë organizata të shoqërisë civile, medie investigative dhe grupe të të drejtave të njeriut, për të cilët është e rëndësishme jo vetëm njohja e rolit të tyre. Kuvendi luan një rol të veçantë në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Aktualisht, ka disa mekanizma në Kuvend, që nxisin dhe promovojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, sikurse kemi edhe mekanizmat e kontrollit parlamentar.

Në këtë rezolutë, në qoftë se ju kujtohet... Rezoluta është produkt i një forumi të zhvilluar për mbrojtësit e të drejtave të njeriut në prill të vitit 2018.

Bazuar në kërkesën tuaj, zoti kryetar, ne kemi bërë një konsultim publik dhe kemi mbledhur opinione të organizatave të shoqërisë civile dhe, mbi të gjitha, të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, ku një rol të veçantë ka luajtur Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe një sërë organizatash të drejtave të njeriut. Me porosinë tuaj, drafti u është përcjellë të gjitha organizatave të të drejtave të njeriut dhe institucioneve të pavarura. Ne kemi marrë mendime nga Avokati i Popullit, nga Komisioneri për Parandalimin e Diskriminimit, nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, si dhe nga CRCA-ja.

Meqenëse kolegja Xhina është relatores e kësaj nisme, jemi ulur së bashku me këshilltaren ligjore, zonjushën Koka dhe zonjën Bushka, që është edhe anëtare e delegacionit

tonë në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, dhe kemi reflektuar të gjitha detyrimet që ka parlamenti shqiptar në kuadër të angazhimeve në Këshillin e Europës, Bashkimin Europian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si dhe të gjitha angazhimet që kemi marrë në kuadër të rezolutave dhe detyrimeve, që burojnë nga konventat në të cilat Shqipëria është palë.

Për konsultimin publik, të nderuar kolegë, shumica e rekomandimeve të adresuara nga Komisioneri për Parandalimin e Diskriminimit dhe Avokati i Popullit janë marrë në konsideratë. Gjithashtu, është marrë në konsideratë pjesa më e madhe sugjerimeve të bëra nga qendra për Nisma Ligjore e Qytetare. Njëkohësisht, kemi ndarë shqetësimin e Qendrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA), por jemi treguar shumë të kujdesshëm, në kuadër edhe të shqetësimit që keni ngritur ju, zoti kryetar, që të mos dublojmë mekanizmat që ka aktualisht Kuvendi. Prandaj, gjatë miratimit të projektrezolutës kemi bërë riformulime të paragrafëve...

Ulsi Manja – Kolegë, ju lutem, se mbaruam!

Vasilika Hysi - ...me qëllim që të mos dublojmë punën e mekanizmit ndërinstucional që ka ngritur Kuvendi me vendimin nr.49/2017.

Nga ana tjetër, rritet roli i Komisionit të Ligjeve dhe i Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, si dhe roli i gjithë Kuvendit nëpërmjet mekanizmave të kontrollit parlamentar, duke vënë në fokus mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Zonja Xhina, keni diçka për të shtuar?

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zonjën Hysi për parashtrimin që bëri!

Dua të flas për ndryshimet që kemi bërë në tekstin e projektrezolutës, të cilat po i parashtroj në mënyrë të përmbledhur.

Në pjesën hyrëse të projektrezolutës, në reflektim të komenteve të paraqitura nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, propozohet shtimi i një paragrafi për njohjen e rolit të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu mbrojtësit e të drejtave të grave dhe të grupeve të tjera vulnerabël.

Njëkohësisht, në referim të parashikimeve që kanë bërë rezolutat nr. 22 dhe nr. 25, rekomandimi nr. 2085 dhe rezoluta nr. 2095 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, të reflektohet sugjerimi i Komisionerit për shtimin e një parashikimi për marrjen e masave për

të mbrojtur mbrojtësit e të drejtave, jo vetëm nga sulmet apo ngacmimet e bëra nga zyrtarët publikë, por edhe nga aktorët joshitetorë.

Në pjesën hyrëse reflektohet edhe sugjerimi i Avokatit të Popullit për njohjen e rolit të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj, për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të individit.

Në pjesën hyrëse është bërë edhe një rirenditje paragrafëve, që i përket teknikës legjislative.

Në pikën 1 të projektrezolutës është bërë një ndryshim në formulim, me qëllim që të bëhet më i qartë roli i Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Për paragrafin 2 reflektohet sugjerimi për përcaktimin e një afati konkret (6 muaj) me miratimin e planit të veprimit, për promovimin dhe mbështetjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Me qëllim shmangien e paqartësive, pika 4 hiqet, pasi e drejta për ndërmarrjen e nismave ligjore është e sanksionuar në Kushtetutë, se cilët mund ta marrin dhe ta nisin si ndërmarrje.

Në pikën 6 reflektohet sugjerimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shtimin e kategorive të tjera të grupeve vunerabël, ku përfshihen fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, si dhe viktimat e dhunës dhe të trafikimit.

Në kuadër të përshtatjes së projektrezolutës me qëllimet dhe mesazhet që kërkohen për zgjedhjen, në vijim të sugjerimeve të Avokatit të Popullit, vlerësohet që pika 7,8,9 dhe 10 të hiqen nga teksti.

Në pikën 15 sugjerohet të reflektohet komenti i Avokatit të Popullit përfshirjen e ministrit të Drejtësisë, në varësi të të cilit është edhe Policia e Burgjeve, si dhe të riformulohet për të qenë e qartë nga pikëpamja e teknikës legjislative.

Pika 16 dhe 17 riformulohen, me qëllim qartësimin e përmbajtjes dhe në përputhje me rolin dhe fushën e ndërgjegjësimit të çdo institucioni që promovon të drejtat dhe liritë e njeriut.

Këto janë ndryshimet e projektrezolutës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe gjuhës së teknikës legjislative, e cila do të reflektohet në tekstin e përfunduar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Xhina, për sugjerimet dhe punën që keni bërë për projektrezolutën, së bashku me zonjën Hysi dhe këshilltarët!

Kanë pyetje kolegët për projektrezolutën?

Bashkim Fino – Me leje?

Ulsi Manja – Zoti Fino ka pyetje.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, Adnor!

Pyetja që kam unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...Rezoluta duhet të bëhet më funksionale, që të mos mbetet thjesht një rezolutë e formalizuar dhe e shkruar vetëm në format.

E kuptoj pikën 3, që nënkomsioni brenda 6 muajve nga miratimi i kësaj rezolute, pra kur ta miratojmë në parlament, pavarësisht se ky draft është bërë që në korrik të vitit të kaluar, por problemi....

Vasilika Hysi - Është bërë 9 tani.

Bashkim Fino – Nga pika 8 deri në pikën 16, me sugjerimit që bëri edhe relatorja, ka disa situata ku thuhet: “T’i kërkojmë Këshillit të Ministrave ngritjen e strukturës ndërministrare, t’i kërkojmë Këshillit të Ministrave të paraqesë raport vjetor...”

Vasilika Hysi – I hoqëm këto.

Bashkim Fino – Prit!

Ulsi Manja – Ju lutem, të mbarojë zoti Fino!

Bashkim Fino – Unë nuk jam kundër që t’ia kërkojmë, edhe nëse e ke hequr ndonjë formulim, se e dëgjova relatoren. Shqetësimi që kam është që duhet të vëmë afate konkrete në projektrezolutë, që, kur ta miratojmë dhe kur të na raportojnë një herë në vit nga qeveria, të dimë që në bazën e këtyre afateve janë bërë ose jo këto çështje që kemi trajtuar, që të mos ngelet thjesht në letër dhe të mos zgjidhet gjë. Me letrat mund të jemi në rregull, por puna është të bëjmë diçka konkrete. Ne kemi gjithë këto institucione, të cilat prekin liritë dhe të drejtat e njeriut. Këtë sugjerim kisha.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Pra, që të mos ngelet thjesht rezolutë deklarative duhet të ketë edhe mekanizmat e kontrollit.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Shumë faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit kolegut Fino! Këtë shqetësim e ka ngritur edhe në diskutimin në parim të projektrezolutës, me të drejtë.

Në paragrafin 2 dhe 3 kemi parashikuar që brenda afatit 9-mujor nga miratimi i rezolutës, të përgatitet raporti i parë. Në fakt, draftin fillestar të rezolutës e lamë 6 muaj, duke menduar se do të kalonte vitin e kaluar, por duke qenë se ne kemi përpara zgjedhjet dhe në periudhën e verës nuk arrihet të bëhet një raport i detajuar, që t'i paraqitet Komsionit të Ligjeve...

Shqetësimi i zotit Fino zgjidhet, sepse ne kemi thënë që brenda 6 muajve nga paraqitja e raportit, do të përgatitet një plan veprimi i Kuvendit. Në planin e veprimit të Kuvendit do të ketë afate konkrete për të gjitha problematikat që rezultojnë nga raporti. Për momentin nuk vëmë dot afate, se nuk e dimë se çfarë problemesh do të na dalin nga analiza e situatës së gjendjes së mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Këtu do të jenë aktive institucionet e pavarura kushtetuese dhe aktorët e shoqërisë civile, përfshirë edhe medien investigative, që është një nga mbrojtëset e të drejtave të njeriut. Shqetësimi i kolegut Fino është shumë i drejtë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

(Deputeti Bashkim Fino flet pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ndize mikrofonin!

Bashkim Fino – Çfarë vëmë në lëvizje me këtë rezolutë në qoftë se e votojmë? Ky është thelbi: a vëmë diçka në lëvizje apo nuk vëmë asgjë në lëvizje dhe presim që në bazë të të dhënave dhe këtyre afateve, do të veprojmë?

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për pyetjen! Është thelbi dhe qëllimi i kësaj rezolute.

Është hera e parë që Kuvendi merr një angazhim konkret për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, jo se nuk kemi angazhime për bashkëpunimin për bashkëpunimin me shoqërinë civile për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por statusi i mbrojtësit të të drejtave të njeriut është diçka e veçantë. Ne marrim disa angazhime.

Së pari, Komisioni i Ligjeve, nëpërmjet nënkomisioneve të tij do të bëjë një raport të situatës të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, që deri më sot mungon.

Së dyti, mbi bazën e këtij raporti dhe gjetjeve do të ketë një plan veprimi, që deri më sot mungon.

Së treti, ky plan veprimi do të ketë afate konkrete se çfarë duhet të bëjmë ne për të promovuar nismat e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, por, mbi të gjitha, për t'i mbrojtur ata.

Së katërtri, janë të gjitha paragrafët e tjerë ku ne themi se inkurajojmë medien, nxisim Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Për secilën nga këto, në planveprim do të ketë detyrime konkrete, se ne kemi një sërë ligjesh të miratuara në parlament: ligji për të huajt, ligji për shtetësinë, ligji për mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Ne kemi detyrimin që, institucione të tilla, si Avokati i Popullit, Komisioneri, jo vetëm t'i mbështesim, por duhet t'i forcojmë nga pikëpamja e burimeve njerëzore, financiare dhe e pavarësisë së tyre. Në këtë kuadër, ne do të adresojmë një sërë nismash ligjore ose do të forcojmë kontrollin parlamentar nëpërmjet mekanizmit ndërinstitucional apo punës që mund të bëjnë komisionet dhe nënkomisionet e tjera, se nuk është vetëm komisioni ynë.

Së fundi, për ta bërë të qartë këtë, besoj se në këtë mënyrë Kuvendi plotëson një komponent, që është shumë i rëndësishëm: komponentin e monitorimit, e respektimit të të drejtave të njeriut, jo vetëm nga institucionet shtetërore, por edhe me një bashkërendim më të mirë të punës së institucioneve në mbrojtje të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, ku një rol të veçantë luan media dhe organizatat e të drejtave të njeriut.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ka pyetje të tjera ose diskutime?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Mendoj se bëra mirë që ndërhyra në dy-tri momente me pyetjet e mia, sepse u bë më shteruese më fjalën e zonjës Hysi gjithë rezoluta që ne do të kalojmë në parlament. Vetëm kështu ne mund të jemi efektivë si komision, në funksion të miratimit të kësaj rezolute dhe të afateve konkrete që duam të vëmë për të kontrolluar.

Pjesa më delikate e gjithë kësaj rezolute është kontrolli parlamentar, për të cilën, për hir të së vërtetës, ne, si parlament, në përgjithësi vuajmë, në kuptimin që nuk i bëjmë gjërat ashtu siç duhet, edhe për shkak të kompetencës që kemi dhe të vendimmarrjes. Në qoftë se do t'i bëjmë me koshiençë të plotë të gjithë afatet konkrete që do të miratojmë dhe do të kontrollojmë të gjitha institucionet përkatëse, të jeni të bindur që do të ketë një efekt rezoluta. Ne përgjithësisht duhet të jemi shumë të vëmendshëm kur duhet të miratojmë rezoluta në parlament.

Të nderuar kolegë, rezolutat në parlament janë udhërrëfyesi, orientuesi, që ne, si parlament, u bëjmë institucioneve përkatëse, të cilat, në zbatim të ligjit, duhet të jenë konkrete dhe ne duhet t'i kontrollojmë për të nxjerrë gjërat më kryesore të tyre.

Kur raportojnë një herë në vit institucionet kushtetuese në komisionin tonë të nderuar, absolutisht, rezoluta do të kenë një vlerë të rëndësishme, sepse mbi bazën e rezolutës së vitit të kaluar, ne duhet të bëjmë vlerësimin profesional të drejtuesve të institucionit, të atyre që kemi zgjedhur dhe të atyre që drejtojnë, se zakonisht këto rezoluta kanë ngelur në kuadrin e organizimit thjesht në letër dhe ne nuk merremi me rezolutën e kaluar.

Do të kërkoj nga ju, zoti kryetar, si dhe nga stafi i komisionit, që herë tjetër kur të kalojmë rezoluta apo kur të vijnë institucionet, sipas programit që miratuam, të kemi parasysh rezolutën e vitit të kaluar që ka kaluar parlamenti, që ne të kërkojmë llogari dhe të diskutojmë këtu me drejtues të institucioneve, pavarësisht asaj që ata kanë realizuar me rezolutën e miratuar një vit më parë dhe të atyre që propozojmë ne si projektrezoluta të vitit në vazhdim.

Shumë faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Jam dakord me atë që sugjeron zoti Fino. Në fund të fundit, raportimi i institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, në Komisionin e Ligjeve dhe më pas në Kuvend, këtë qëllim ka, se si janë zbatuar detyrat e lënë në rezolutën paraardhëse të Kuvendit, përpos detyrave të tjera funksionale, që ligjet e tyre përkatëse ua ngarkojnë këtyre institucioneve. Ky do të jetë edhe fokusi i kontrollit parlamentar të Komisionit të Ligjeve për këtë vit, kur të vijë koha e raportimit të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, sipas këtij kalendari që sapo miratuam.

Duke ju falënderuar për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në fazën e votimit tani.

Duke ju falënderuar për përfshirjen në këtë diskutim të rëndësishëm, mendoj ta hedhim në votim këtë projektrezolutë.

Kush është dakord me projektrezolutën?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet projektrezoluta “Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë”, me ndryshimet përkatëse të propozuara në komision nga dy relatorët, që u paraqitën edhe në komision.

Teksti i projektrezolutës, së bashku me raportin përkatës, të bëhet gati për seancën plenare, për të enjten që vjen.

Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA